



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 3, datë 31.01.2022

**PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E SHOQËRISË AUDITUESE
PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË AMF-SË, PËR VITIN 2021**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 16, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e kriterëve për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2021, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE

Kriteret për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të AMF-së, për vitin 2021 janë si më poshtë:

- a. Të jetë i licencuar apo i regjistruar në regjistrin publik si Auditues Ligjor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë;
- b. Të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë të kenë titull profesional “Auditues Ligjor”;
- c. Të ketë mbi 5 (pesë) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave ose subjekteve të tjerë financiare apo autoritete rregullatore financiare që aplikojnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve);
 - c/1. Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku ekipi i auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të auditimit) të ketë minimumi dy anëtarë me përvojë në kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore;
- d. Të mos ketë konflikt interesash me subjektin që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”;
- e. Të mos jetë subjekt i parashikimeve të nenit 55, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor”, sipas afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
- f. Të paktën njëri nga anëtarët e grupit të auditimit të ketë fituar titullin ACCA/CFA.